

UDHËZUES PËR MEDIA

Inteligjenca Artificiale dhe etika në gazetari



Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
Press Council of Kosovo
Savet Štampe Kosova

Përderisa Inteligjenca Artificiale (AI) po bëhet çdo ditë e më shumë pjesë e punës së gazetarëve, mediat duhet të sigurohen për përdorim të përgjegjshëm të këtyre teknologjive.

Bota e medias po ndryshon me shpejtësi dhe modele të ndryshme të AI-së mund të shkruajnë artikuj, të krijojnë burime lajmesh të personalizuar ose të përmbledhin informacione shpejt. Aplikacionet gjeneruese të AI-së po ndikojnë në media, duke ngritur dilema në lidhje me efektet e tyre te gazetarët dhe në saktësinë e lajmeve.

Udhëzuesit si ky, i hartuar bazuar në teoritë dhe praktikën më të mira profesionale, synojnë të ndihmojnë gazetarët dhe mediat në përdorimin e përgjegjshëm të AI-së, duke promovuar etikën, transparencën dhe drejtësinë, si parime thelbësore për ruajtjen e vlerave të gazetarisë.

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (KMShK) ka përfshirë me kohë në Kodin e Etikës rregulla, sipas të cilave mediat duhet raportuar kur përdorin Inteligjencën Artificiale.

Ilustrimet e përfshira në këtë udhëzues janë gjeneruar me ndihmën e AI-së

Qershor, 2026

Inteligjenca Artificiale dhe etika në gazetari

Inteligjenca Artificiale (AI) po shpërfaq ndryshime thelbësore në mënyrën se si njerëzit informohen dhe komunikojnë. Në këtë kontekst, është jashtëzakonisht i rëndësishëm roli i etikës në përdorimin dhe zhvillimin e teknologjive AI nga gazetarët dhe mediat.

AI po ndikon thellësisht në media, duke sjellë automatizimin e redaktimit, personalizimin e përmbajtjes dhe përmirësimin e përvojës së përdoruesve. Ndërhyrjet e teknologjive të avancuara janë duke krijuar një mjedis të ri për informacionin dhe komunikimin.

Përderisa teknologjitë AI janë një burim i pasur për shkëmbimin e informacionit, ato sjellin edhe sfida dhe dilema me të cilat mediat ballafaqohen. Rreziku i përhapjes së informacionit të rremë, problemet me privatësinë dhe shfaqja e favorizimeve algoritmike janë disa nga to.

Etika luan një rol kyç në trajtimin e sfidave që dalin nga përdorimi i AI-së në media. Zhvilluesit dhe përdoruesit e këtyre teknologjive duhet të kenë parasysh pasojat sociale dhe etike të veprimeve të tyre. Një përdorim i përgjegjshëm i AI-së në media përfshin respektimin e lirive individuale, transparencën dhe luftën kundër diskriminimit.

Një nga sfidat kryesore është kontrolli i përhapjes së informacioneve të pavërteta dhe të manipuluar. Përdorimi i AI-së për verifikimin e fakteve dhe identifikimin e lajmeve të rreme është kthyer në një fushë të rëndësishme të hulumtimit dhe zhvillimit.

Ndërgjegjësimi i përdoruesve është thelbësor për të krijuar një mjedis mediatik më të qëndrueshëm dhe etik. Edukimi rreth funksionimit të algoritmeve, transparencës së përdorimit të tyre dhe impaktit social të teknologjive AI ndihmon në shpërndarjen e një kulture më të kujdesshme dhe etike.

AI po sjell një ndryshim të thellë në mënyrën si krijohet, shpërndahet dhe konsumohet informacioni. Për të siguruar një përdorim të përgjegjshëm dhe etik të këtyre teknologjive, është e rëndësishme që zhvilluesit, përdoruesit dhe shoqëria në përgjithësi të angazhohen në diskutime të hapura rreth sfidave dhe mundësive që ofron ky ndryshim paradigme.

Gazetarët nuk janë vetëm transmetues të thjeshtë informacioni, por duhet të ofrojnë edhe kontekst raportimi. Andaj, një pyetje thelbësore është nëse ndonjë softuer do të jetë ndonjëherë në gjendje t'i zëvendësojë plotësisht ata në profesionin e gazetarisë.

Përdorimi i teknologjive AI dhe etika në raportim

-Mediat mund të përdorin Inteligjencën Artificiale në procesin e krijimit të përmbajtjes mediale, por në mënyrë të përgjegjshme dhe proporcionale. Kur përdorin teknologji AI, mediat duhet të respektojnë parimet e mbrojtjes së të dhënave personale, sigurisë së informacionit dhe mosdiskriminimit.

- Përmbajtja mediatike e krijuar me ndihmën e AI-së bie në përgjegjësinë editoriale të medias dhe nuk i liron gazetarët dhe redaktorët nga përgjegjësia për të respektuar asnjë rregull të parashikuar nga kodi i Mediave të Shkruara të Kosovës.

- Mediat janë të obliguara t'i informojnë lexuesit në mënyrë të përshtatshme për përdorimin e AI-së në krijimin e përmbajtjes mediale, me shënimin se në cilin segment dhe çfarë lloji i AI-së është përdorur dhe si funksionon.

- Gjatë përdorimit të AI-së mediat duhet të respektojnë të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të pronësisë intelektuale. Nëse konsumuesit e përmbajtjeve mediale kanë ndërveprime me AI, ata duhet të informohen paraprakisht se ato nuk po bëhen me njerëzit.

- Në lidhje me vendimet e marra nga AI, të cilat mund të shqetësojnë lexuesit, atyre duhet t'iu sigurohet komunikimi me një person fizik dhe mundësia për të kundërshtuar vendimin përkatës.



Sfidat e përdorimit të AI-së

- 1 Vlerat editoriale:** Është e domosdoshme përfshirja e gazetarëve në procesin e krijimit të lajmeve. Verifikimi dhe kontrollimi i fakteve është thelbësor, duke siguruar që përmbajtjet egjeneruara nga AI të trajtohen me të njëjtën rigorozitet si raportimi tradicional. Etika dhe kreativiteti njerëzor janë të pazëvendësueshme.
- 2 Dezinformimi:** AI mund të krijojë përmbajtje të rreme, duke dëmtuar kështu besimin e publikut në media. Mediat duhet të adresojnë menaxhimin e rreziqeve të tilla në mënyrë efektive.
- 3 Transparenca:** Mediat inkurajohen të jenë të qarta në rastet kur përdorin AI për të krijuar përmbajtje mediale. Kjo është thelbësore për ruajtjen e besimit të audiencës.
- 4 Llogaridhënia:** Mediat duhet të marrin përgjegjësi për përmbajtjen e gjeneruar nga AI, duke siguruar që dikush të mbikëqyr gjithmonë prodhimin e saj dhe që ajo të jetë në përputhje me standardet profesionale.
- 5 Drejtësia:** Sistemet e AI-së duhet të jenë të dizajnuara për të minimizuar paragjykimet. Kjo do të thotë që algoritmet e përdorura nga këto sisteme nuk duhet të synojnë ose të dëmtojnë padrejtësisht grupe të caktuara.
- 6 Privatësia:** Mbrojtja e të dhënave të përdoruesve është shumë e rëndësishme. Mediat duhet të sigurojnë që çdo e dhënë e mbledhur të trajtohet me përgjegjësi. Përmbajtjet e gjeneruar nga AI duhet të shenjohen në mënyrë transparente.
- 7 Aftësimi i gazetarëve:** Përderisa AI integrohet gjithnjë e më shumë në media, ekziston një hendek ndërmjet atyre që mund të punojnë në mënyrë efektive me mjetet e AI-së dhe atyre që nuk mundën. Programet e vazhdueshme të trajnimit dhe mbështetjes për gazetarët janë thelbësore.
- 8 Efikasiteti në punë:** Ekzistojnë shqetësime se AI mund të zëvendësojë role të caktuara gazetareske, veçanërisht ato që lidhen me raportimin e përditshëm dhe analizën e të dhënave. Mediat duhet të gjejnë një ekuilibër ndërmjet efikasitetit dhe ruajtjes së vendeve të punës.

AI dhe gjuha e urrejtjes


Rrjetet sociale përdorin modele të Inteligjencës Artificiale për të zbuluar dhe trajtuar gjuhën e urrejtjes në internet. Më sfiduese është zbulimi i gjuhës së urrejtjes në përmbajtjet video por, natyrisht, është e mundur me zhvillimin e algoritmeve të ndryshme.

Modele të ndryshme të AI-së mund të analizojnë sasi të mëdha të përmbajtjes pothuajse në kohë reale. Kjo mundëson zbulimin e gjuhës së urrejtjes dhe mund të parandalojë përhapjen e përmbajtjeve kontestuese.

Duhet t'i kushtohet kujdes identifikimit të saktë të gjuhës së urrejtjes, e cila shprehet nëpërmjet sarkazmit, ironisë ose referencave kulturore. Përdoruesit mund t'iu ekspozohen vetëm përmbajtjeve që përputhen ekskluzivisht me pikëpamjet dhe bindjet e tyre, duke e amplifikuar potencialisht gjuhën e urrejtjes në komunitete të caktuara.

Adresimi i paragjyqimeve të algoritmeve ndaj cilësdo qoftë kategorie grupesh dhe qytetarësh kërkon një kombinim të strategjive të orientuara nga të dhënat, rregullat etike dhe përkushtimi për të nxitur diversitetin dhe gjithëpërfshirjen në zhvillimin dhe aplikimin e teknologjisë.

Në “betejën” ndërmjet autorëve të përmbajtjeve problematike, si krijues dhe AI-së, si mekanizëm parandalues, është thelbësore që të ruhet dhe respektohet liria e shprehjes.



AI dhe gazetaria më e mirë

Përdorimi i përgjegjshëm i AI-së mund të mbështesë gazetari më të mirë, jo ta zëvendësojë atë.

Gazetarët dhe redaktorët mbeten përgjegjës për gjithçka që prodhojnë dhe publikojnë. Në rastet kur përmbajtjet e gjeneruara nga AI, siç janë përgjigjet e chatbot-ëve, publikohen pa shqyrtim paraprak njerëzor, këto mjete duhet të jenë të dizajnuara me masa mbrojtëse të qarta dhe të monitoruara rregullisht nga media.

AI mund të përdoret për të ndihmuar në prodhimin, transkriptimin dhe përkthimin e përmbajtjeve, por gjithnjë duke respektuar kodet e etikës. AI mund të përdoret në mënyrë të përgjegjshme për të ndihmuar edhe redaktim tekstesh, përkatësisht identifikim problemesh gramatikore, sugjerim përmirësimesh të stilit ose riformulim të fjalive për qartësi.

Informacione private ose të ndjeshme nuk duhet të përfshihen në vegla të teknologjive të AI-së. Gjithnjë duhet treguar nëse personalizimi ose rekomandimet e ndryshme drejtohen nga AI.

Në gazetarinë vizuale imazhet e gjeneruara nga AI mund të përdoren me masë dhe transparencë. Një vegël e AI-së mund të përdoret për të vizualizuar diçka që nuk është e mundur të fotografohet ose xhirohet, por jo për të ndryshuar njerëz ose ngjarje të vërteta.

Të gjitha përmbajtjet e gjeneruara nga AI duhet të rishikohen nga redaktorët, të shenjohen qartë dhe të arsyetohen nga aspekti editorial për mënyrën se si dhe pse janë krijuar.

Këshilla praktike për gazetarët (dhe jo vetëm)

Mos i ndani asnjëherë me teknologjitë AI të dhënat personale, si numri i letërnjoftimit ose pasaportës, adresa, data e lindjes, numri i telefonit etj.

Mos i ndani as të dhëna shëndetësore, financiare - siç janë llogaritë bankare - që mund t'ju identifikojnë

Mos i ndani me AI fjalëkalimet ose llogaritë tuaja - emra përdoruesish, fjalëkalime, kode sigurie.

Mos i ndani me AI të dhënat e punës dhe të kompanisë. Duke përdorur ChatGPT për emaila ose dokumente të ndryshme në punë, rrezikoni të ndani pa dashur informacione konfidenciale të kompanisë ose dokumente të brendshme të ndjeshme

Gjatë shfrytëzimit të AI-së për punë, privatësia mbrohet duke përdorur fjalëkalime të forta, autentifikim me dy faktorë,



unesco



Funded by
the European Union



Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
Press Council of Kosovo
Savet Štampe Kosova

Ky publikim është pjesë e projektit të UNESCO-s “Ndërtimi i besimit në media në Evropën Juglindore: Mbështetje për gazetarinë si e mirë publike”, i financuar nga Bashkimi Evropian.

Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim janë ekskluzivisht të KMSHk-së dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e UNESCO-s dhe të Bashkimit Evropian.